

20091142170

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
ME KREDI TE BEZHR SIPAS MARRËVESHJES PËR PROJEKT-PROGRAMIN
AKSIONAR PËR PËRPARIMIN E KOMUNAVE DHE MJEDISIT JETËSOR NË
KUMANOVË, VELES, SH TIP, STRUMICË, OHËR/STRUGË

Neni 1

Në Ligjin për ngarkimin e Republikës së Maqedonisë të BEZHR sipas Marrëveshjes për Projekt-programin aksionar të komunave dhe mjedisit jetësor në Kumanovë, Veles, Shtip, Strumicë, Ohër/Strugë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 107/2000), neni 6 ndryshohet si vijon:

“(1) Në rast se Republika e Maqedonisë nëpërmjet Ministrisë së Financave, në emër të shfrytëzuesve të fundit të kryejë pagesën e anuiteteve të llogaritura të verifikuara në pajtim me marrëveshjet e lidhura me Ministrinë e Financave, Ministria e Financave ka të drejtë të arkëtimit të kërkesave të maturuara që përshin kryegjënë, kamatën, kamatës së vonuar dhe shpenzimeve të tjera të bëra për shkak të pamundësisë së shfrytëzuesit të fundit të kredisë, të kryejë servisimin e detyrimit të ndodhur në datën e arritjes dhe në afat prej 30 ditësh ti zbatojë masat e arkëtimit të mjeteve nga komuna/komunat themeluese të ndërmarrjeve publike në pajtim me Ligjin për borxh publik.

(2) Ministria e Financave, për detyrimet e maturuara në bazë të së cilave i është bërë pagesën, për arkëtimin e maturuar të kërkesës nga shfrytëzuesit e fundit të kredisë, mund t’u mundësojë riprogram të ri të borxhit me afat pagese prej 36 këstesh mujore dhe llogaritje të kamatës së rregullt, në lartësi të shkallës së kamatës eskonte të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën vijuese nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.